



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke



ZL.Anr. 861/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarë: Gyltene Sylejmani kryesuese, Rafet Haxhaj dhe Adnan Konushevci anëtar, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Arjeta Sylja, duke vendosur për apelin e Duško Maksimoviqit, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Graçanicë, nga subjekti politik Samostalna Liberalna Stranka (SLS), dega në Graçanicë, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017, për publikimin e rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve lokale për anëtarët e Kuvendit Komunal, të mbajtur më 22 tetor 2017, në seancën e Panelit të mbajtur më 11.11.2017, morri këtë:

V E N D I M

I. Pranohet si i bazuar apeli i paraqitur nga Duško Maksimović, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Graçanicë, nga subjekti politik Samostalna Liberalna Stranka (SLS), dega në Graçanicë, dhe **ANULOHEN** 75 fletëvotimet e subjektit politik Samostalna liberalna stranka (SLS), dega në Graçanicë, në vendvotimet BM234/001, BM234/002, BM234/003, për kandidatin për anëtar të Kuvendit Komunal në Komunën e Graçanicës, Goran Lazić me numër rendor 14, për Zgjedhjet Lokale të mbajtura me datë 22.10.2017.

II. Urdhërohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), që të rinumëroj të gjitha fletëvotimet për Vendvotimet BM234/001, BM234/002, BM234/003, për të gjitha subjektet politike dhe të kandidatëve të tyre, duke i përjashtuar nga rezultati përfundimtar fletëvotimet si në pikën -I-, të dispozitivit të këtij vendimi.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 10.11.2017, nga Duško Maksimović, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Graçanicë, nga subjekti politik Samostalna Liberalna Stranka (SLS), dega në Graçanicë, me të cilën pretendon se ka pasur parregullsi gjatë numërimit të votave të ardhura me Postë, për komunën e Graçanicës. Më tutje thekson se është i dëmtuar dhe kërkon rinumërimin e votave dhe verifikimin e rregullsisë së atyre votave për SLS-në.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i shqyrtoj pretendimet ankimore dhe materialin zgjedhor e pas vlerësimit të gjithanshëm të tyre gjeti se:

Apeli është i bazuar

Paneli, me datë 11.11.2017, në përbërje të ekipit nga gjyqtarët dhe zyrtaret hetues të PZAP-it, ka zhvilluar hetimet për të vërtetuar themelësinë e pretendimeve ankimore dhe gjeti se pretendimet ankimore janë të bazuara. Kjo pasi që është bërë shikimi i fletëvotimeve një për një si dhe është bërë krahasimi i tyre dhe ka rezultuar se në Vendvotimet me Post: BM234/001 janë shikuar 42 fletëvotimet për subjektin politik SLS, në vendvotimin BM234/002 janë shikuar 2 fletëvotime për subjektin politik SLS, dhe në vendvotimin BM234/003, janë shikuar 31 fletëvotime për subjektin politik SLS, dhe paneli konstatoi se të gjitha fletëvotimet e lartpërmendura janë plotësuar nga i njëjti person dhe me të njëjtin laps kimik, si dhe që në të gjitha fletëvotimet ka qenë i përzgjedhur dhe i shenuar vetëm kandidati me nr. 14, nga subjekti politik SLS.

Prandaj, nga arsyet e lartpërmendur, paneli konstaton se fletëvotimet e lartpërmendura janë plotësuar nga i njëjti person dhe me të njëjtin laps kimik edhe përkundër faktit se mënyra e votimit është me post në vendvotimin e ankimuar, e që nënkuptohet se votuesit janë nga vende të ndryshme dhe fletëvotimet dorëzohen në pika të ndryshme postare.

Paneli pas vlerësimit të pretendimeve ankimore dhe gjetjeve nga ekipi hetues i PZAP-it, në QNR konkretisht në kutitë e votimit të Vendvotimeve BM234/001, BM234/002, BM234/003, erdhi në përfundim se në rastin konkret bëhet fjalë për plotësimin e fletëvotimeve nga i njëjti person – jo në mënyrë të ligjshme dhe të cilat veprime në bazë të LZP-së, përbejnë padrejtësi serioze. Andaj paneli duke u bazuar në nenin 119 par.5 të LZP-së, i cili përcakton se: “PZAP-i, mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të ndryshme të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar një padrejtësi serioze”, e më qëllim të evitimit të këtyre padrejtësive e duke u bazuar edhe nënen 117 par.2, 118 par 1 dhe nenin 120 par.1 pika d) të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
A nr. 861/2017 më datën 11.11.2017.

Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve, nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.

